



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 06/2018

Datë: 09. 03.2018. Ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Stevan Veslinoviq, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 04/2018*

3. Raport i Këshillave të KQZ-së

- **Këshilli për Çështje Ligjore:**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim ndryshimit të Rregullores Nr.02/2017 për Përshkrimin e Detyrave të Punës dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit e KQZ-së;*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për ndryshim të emrit të partisë politike nga "Partia Ekologjike e Kosovës-PEK" në "Eko Lëvizja e Gjellbër-ELGJ";*

- **Këshilli i personelit:**

- *Shqyrtim dhe miratimi i përshkrimet e vendeve të punës të stafit të SKQZ-së;*

- **Këshilli i Operacioneve Zgjedhore:**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për ruajtjen e vendvotimeve të zgjedhjeve Lokale 2017 që kanë dallim në vota pas rinumërimit;*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i Projektit të bashkëpunimit me Asociacioni i Trupave Zgjedhore Botërore (A-ĒEB):*

4. Të ndryshme

2. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 04/2018

Valdete Daka: A ka dikush vërejtje...?

Ercan Spat: Kam pyetje për Sekretariatit: në pikën e dytë të rendit të ditës, çka kanë paraparë...?

Binak Vishaj: Kemi thënë se, në mbledhje kemi me sjellë edhe materialin nga Komiteti i Auditimit. Ne e kemi mbajtur takimin, por për shkak se materiali është voluminoz dhe duhet të përkthehet, por ne e kemi kryer punën dhe besoj. Janë, më shumë çështje teknike! Në mbledhjen tjetër, do të jetë gati...

Sami Hamiti: Unë kam pritur që të sillet sot, është dashur me u krye puna, pavarësisht sa material ka pas...! Premtimi, nuk është mbajtur. Materiali nuk ka ardhur...

Valdete Daka: atëherë, premtimi nuk është mbajtur por, kush është për këtë rend dite...?

1. *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 04/2018*

Në vazhdim të mbledhjes, anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalin nr. 4/ 29018.

3. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore:

Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim ndryshimit të Rregullores Nr.02/2017 për Përshkrimin e Detyrave të Punës dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit e KQZ-së

Sami Hamiti: Në mbledhjen e këshillit, i kemi shqyrtuar dy pika të rendit të ditës: plotësim ndryshimi i Rregullores Nr.02/2017 për Përshkrimin e Detyrave të Punës dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit e KQZ-së, dhe ndryshimi i emrit të partisë politike: Nga “Partia Ekologjike e Kosovës-PEK”, në “Eko Lëvizja e Gjellbër-ELGJ”. Në mbledhje, pikën e parë, pas shqyrtimit, e kemi rekomanduar që, të shqyrtohet...

Këshilli i personelit:

Shqyrtim dhe miratimi i përshkrimet e vendeve të punës të stafit të SKQZ-së

Bajram Ljatifi: Këshilli i Personelit, ka mbajtur takim sot dhe ka shqyrtuar këtë pikë të përshkrimit të detyrave dhe organogramit të Sekretariatit të KQZ-së, dhe ne rekomandojmë që KQZ t'i aprovoj vendimet tona...

Enis Halimi: Përshkrimet bazohen në rregullore, korrespondojnë edhe me ndryshimet e fundit etj. Pjesë, është edhe organogrami. Nëse ka vërejtje...?

Valdete Daka: S'ka lidhje për cilën pozitë, por unë kam vërejtje. Kërkohej diplomë universitare, por nuk ceket se çfarë diplome. Krejt përshkrimet në konkurs, janë për këso vërejtjeje...! Për mua, janë të përgjithësuese. Nuk është mirë, as çështja e përvojës. Duhet të ceket, cili fakultet, cila përvojë...?

Shefi i prokurimit, a mundet me qenë jurist...?

Sami Hamiti: Po, mundet me qenë...

Adnan Rrustemi: Cili është rasti që, nuk ka hiq...? Mendoj që, duhet me u përfshi se për cilin fakultet është fjala...!

Valdete Daka: Nëse nuk i cekë...? Janë konkurse specifike...Për shembull: udhëheqës i prokurimit...

Enis Halimi: Arsyeja se pse i kemi lënë, i kemi diskutuar meqë, ka fusha shumë...!

Sami Hamiti: Te kjo njësi, te prokurimi, e merr licencën, e mund të jetë i diplomuar në një fushë krejt tjetër...Di raste...

Valdete Daka: Te zyra e partive: thotë “Zyrtarë i lartë për certifikim të partive politike”. Thotë, diplomë universitare në Drejtësi, shkenca Politike ose Administratë Publike së paku 4 vite...! Cfarë përvoje...? Nëse themi katër vite, duhet të specifikohet që të jetë punë profesionale...

Enis Halimi: Kemi diskutuar me KPM, dhe jemi njohur me përvojat e tyre....

Valdete Daka: Jo, duhet të ceket përvojë pune profesionale, që do të thotë nga momenti i marrjes së diplomës...

Ilir Gashi: E thotë edhe ligji: përvoja llogaritet pas diplomimit...Nuk njihet përvoja e punës para diplomimit...

Stevan Veselinoviq: Në të vërtetë, po më intereson se, cilat janë vendet e paplotësuara...?

Enis Halimi: Përmendësh nuk i di, por ua dërgojmë me imell...Në fakt, përshkrimet janë edhe për ato që janë të plotësuara, dhe, edhe për ato që nuk janë të plotësuara...

Valdete Daka: Mirë, nëse ne marrim vendim me e aprovue këtë pikë, sot të marrim vendim edhe për me i shpallë..

Betim Gjoshi: Në përgjithësi, te pozitat që janë specifike, të tjerat nuk është mirë me i ngushtue...Tash mendoj që, duhet me qenë te njëjta për shembull te kryesuesit e KKZ-ve, pra, specifikat të jenë si për anëtarët e KQZ-së...

Valdete Daka: a po e aprovojmë, edhe pse unë kam rezervat e mia në konkurse...!

Sami Hamiti: Përvoja llogaritet, mbasi është marrë diploma...Është edhe në rregulloren për rekrutim..

Bajram Ljatifi: Kjo, është qe dy vite në shqyrtim...!

Pas shqyrtimit të gjerë, anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim

4. Këshilli i Operacioneve Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për ruajtjen e vendvotimeve të zgjedhjeve Lokale 2017 që kane dallim në vota pas rinumërimit.

Adnan Rrustemi: Është lista e përgatitur nga QNR që fletë për ruajtjen e materialit zgjedhor të ndjeshëm të kutive të caktuara ku nuk ka pas mospërputhje në mes të rezultatit në vendvotim, dhe rezultatit pas rinumërimit. I kanë listuar 90 kuti, e të cilat kërkohet që ti kursejmë prej asgjësimit me qëllim që t'ia drejtojmë prokurorisë për hetim, dhe që të shërbejnë si prova materiale...Kemi pasur diskutime në këshill për kriterin që është përdorur, e që kemi konsideruar që është dashur me u përdorë disa kritere, por Sekretariati e ka përdorë numrin e mos përputhjeve prej 50 votave...

Valdete Daka: E nëse i ka pasur 49...?

Adnan Rustemi: Ky është dallimi...! Nuk është bërë analizë, por jemi në situatë që ta miratojmë si të këtillë...Ka vendotime të dyfishta, nuk mendoj që janë shkatërruar të gjitha...

Valdete Daka: Neve nuk na është dërguar lista e atyre që kanë votuar dy herë e më shumë, e ato vendotime janë shkatërruar...Pesëmbëdhjetë herë e kam bërë kërkesën...Le ta mbaj përgjegjësinë Sekretariati...

Adnan Rustemi: Rekomandimi ynë është ta miratojmë...

Betim Gjoshi: Para se me u dërgua në prokurori, duhet me u pa shkaqet, se ka mundur t'i shtohet ndokujt ndonjë zero në KKZ, ose me u harrua votat me u përshkruar...Këto lëndë të zgjedhjeve po ngritën ex officio, dhe kjo po u shkakton njerëzve shumë probleme...Mos të bëjmë gabime. Le të themelohet një komision, dhe të shihen këto 90 kuti...

Pas shqyrtimit të gjerë, anëtarët e KQZ-së e miratuan këtë rekomandim...

Shqyrtimi dhe miratimi i Projektit të bashkëpunimit me Asociacioni i Trupave Zgjedhore Botërore (A-ËEB):

Adnan Rustemi: Në KOZ, e kthym projektin për një analizë më të gjerë, më profesionale etj. Në këtë fazë, bëhet fjalë për t'u përfshi në kornizën afatmesme...Përmbajtja si e këtillë, do t'i nënshtrohet analizës...Ne, vetëm e kthym që të miratohet në parim, pra vetëm sa për t'u përfshirë në kornizë, në planifikim...

Enis Halimi: Ky projekt, përfshinë aktivitete dhe pajisje milionëshe që do të aplikohen në terren, dhe në QNR, brenda rregullativës ekzistuese...Rekomandimi ynë, është së paku që të fillohet në QNR...Por, ky diskutim, është i nevojshëm për ne...

Adnan Rustemi: Po, ama mendoj që të përfshihet edhe raportimi i rezultateve Preliminare. Që, të mos bëjmë projekte të veçanta, si Ki-vote... Ju, vlerësojeni...

Valdete Daka: Ne, jemi për ta vazhduar, pra projekti të përfshihet në buxhet, por cilin projekt e mbështesim, mbetet të shqyrtohet në mbledhjet tjera..

Binak Vishaj: AWEB, investon bashke me ne. Projektet, realizohen në mënyrë të përbashkët prandaj, unë mendoj që ne nuk kemi potencial...

Ercan Spat: Në lidhje me vlerat, ne hyjmë në kushtet kur ne mund të investojmë...Ai, mori si shembull një rast mes AËEB-it dhe Kirgizisë....Unë, jam që në këtë fazë të hyhet në kornizë të shpenzimeve afatmesme...

Valdete Daka: Që ta fusim në kornizë, a mund të tërhiqemi...? Mirë, paskemi kohë edhe tre muaj...

Pas shqyrtimit, anëtarët e KQZ-së e miratuan në parim këtë rekomandim...

5. Të ndryshme

Valdete Daka: Ju njoftoj se OSBE, e ka miratuar kërkesën tonë për Punëtorinë në Tiranë...! Dhe, punëtorja do të mbahet nga: 16 – 19 mars 2018. Shfrytëzoj rastin ta ftojme edhe IFES-in, dhe BE-në, ua dërgojmë ftesat...